



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.11.2021, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 26.10.2021 dhe 1.11.2021.
2. Shqyrtimi dhe miratimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022”.

Marrin pjesë:

Klotilda Bushka, Klevis Xhoxhi, Saimir Hasalla, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Eduard Ndreca, Alqi Bllako, Enkelejd Alibeaj, Saimir Korreshi, Greta Bardeli, Dashnor Sula, Fatmir Mediu, Aurora Mara, Elda Hoti, Gerta Duraku, Toni Gogu, Gledis Çeliku, Bledion Nallbati, Ermonela Valikaj (Felaj), Dhurata Tyli, Bardhyl Kollçaku, Jurgis Çyrbja, Fatmir Xhafaj, Erisa Xhixho dhe Gazmend Bardhi.

Mungojnë:

Damian Gjikhuri dhe Oerd Bylykbashi.

Të ftuar:

Mimoza Dhëmbi – Drejtoreshë e Përgjithshme, Drejtorja e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Vilma Çausholli – Përgjegjëse Sektori e Analizës Buxhetore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Klotilda Bushka – Mirëdita!

Përshëndetje, kolegë!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Çështjen Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut me këtë rend dite: miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 26 tetor dhe 1 nëntor 2021, dhe si pikë të dytë kemi shqyrtimin dhe miratimin nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022”, ku relatorë janë Alqi Bllako dhe Klevis Xhoxhi.

Të ftuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave janë zonja Mimoza Dhëmbi, drejtoreshë e Përgjithshme, Drejtorja e Përgjithshme e Buxhetit dhe zonja Vilma Çausholli, përgjegjëse Sektori e Analizës Buxhetore.

Fjalën e ka zoti Alibeaj, për procedurë.

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë e kuptoj fare mirë që rendi i ditës është ai që ju sapo lexuat, pra që ky komision duhet të shqyrtojë çështje të projektbuxhetit, çështje që me sa duket janë të debatuar, të diskutuar, të votuar dhe qëndrimet politike janë fare të qarta, por ne nuk mund të bëjmë sikur nuk ka ndodhur asgjë për një rast fatkeq, për të cilin flet sot e gjithë Shqipëria. Kjo është një nga çështjet, e cila së paku duhet të kërkoj reagimin njerëzor mbi të gjitha të deputetëve të parlamentit individualisht, si edhe të Komisionit të Ligjeve, një nga komisionet më të rëndësishme. Kushdo që është njohur me këtë ngjarje fatkeqe me pasojat të tilla absolutisht e kërkon këtë lloj reagimi që duhet të bëjë ky komision dhe parlamenti në tërësi.

Të gjithë i kemi parasysh ngjarjet që po ndodhin edhe tani në këto momente, që zhvillon punimet ky komision. Në gjykatën e Fierit, qytetarë, të cilët ndoshta nuk kanë asnjë lloj lidhjeje të afërt, njohje me familjarët e viktimës, i drejtohen në mënyrë të paditur dhe emocionale, duke çarë derën e gjykatës, futen në sallën e gjyqit në kërkim të një shprese që nuk e gjejnë dot në atë mënyrë, duke kërkuar siguri për fëmijët dhe të afërmit e tyre.

Çështja e mungesës së sigurisë duket që është prezente në mendjen e gjithkujt dhe gjithsecili prej nesh i duhet të reflektojë se pse ka arritur sot shoqëria shqiptare në këtë gjendje kaq të rëndë. Pse nuk i referohen ligjit? Pse nuk u referohen institucioneve? Pse nuk e kërkojnë drejtësinë? Ka një problem të madh prej kaq e kaq vitesh që ekziston në këtë shtetin tonë, shtetin e shqiptarëve dhe ku askush nuk e merr në refenë, prandaj mendoj se është vendi, momenti dhe koha minimalisht jo vetëm për një reflektim njerëzor, por mbi të gjitha një reflektim institucional.

Njerëzit sot janë të panikosur, sepse janë të pambrojtur dhe rreziku qëndron gjithmonë pas dere për këdo, pa asnjë lloj dallimi. Njerëzit kanë të drejtë të kërkojnë nga shteti i tyre, nga parlamenti i tyre, sepse, siç duket, nga qeveria e tyre nuk e kanë gjetur, por të paktën nga parlamenti i tyre këtë lloj reagimi për të mos kaluar kështu në heshtje, për të mos bërë sikur asgjë nuk ka ndodhur, duke miratuar buxhetin. Buxhetin e kujt? Për çfarë? Paratë e shqiptarëve. Për çfarë?

A nuk do të duhet që pjesa kryesore të shkojë për shqiptarët, për sigurinë e tyre, për mbrojtjen e tyre për të qenë të qetë në hallet e tyre? Kështu që është e nevojshme dhe e domosdoshme një reagim politik e më pas institucional minimalisht që njerëzit të kuptojnë dhe të sigurohen për atë që është e mundur që ngjarje të tilla të mos përsëriten në të ardhmen, sepse, fatkeqësisht, ata njerëz që çajnë dyert e gjykatave sot në kërkim të drejtësisë së munguar kanë këtë frikë të fshehur thellë në shpirtin e tyre se çfarë i ka ndodhur një familjeje fatkeqe, një vogëlushi nesër apo pasnesër mund t'u ndodhë edhe familjeve të tyre. Është e udhës që së paku ky komision, sepse nuk e patëm fatin në Komisionin e Sigurisë, ta kishte një diskutim të tillë, ta jap një sinjal të tillë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Zoti Alibeaj, për rastin që flisni, sot është vonë, sepse ne të gjithë kemi qenë të pikëlluar, besoj të gjithë krahët e politikës që ditën që ka ndodhur, kemi qenë në seancë plenare dhe sigurisht që çdokush e ndjen kontributin që jep në raste të tilla fatkeqe dhe nuk është e nevojshme ta tregoj dhe të bëj shou, por e rëndësishme është ajo që bëjmë konkretisht, çfarë ne çdo ditë në cilësinë që kemi bëjmë për të parandaluar situata të tilla apo për të monitoruar dhe për të ushtruar kontroll tek ata, të cilët duhet ta bëjnë më mirë detyrën e tyre. Nuk ka ngushëllim për rastin fatkeq të humbjes së jetës së një vogëlushi, duke i qëndruar të gjithë pranë familjes edhe pse nuk mund ta ndihmojmë dot, sepse fëmija nuk mund të kthehet në jetë.

Ajo që duhet të themi është fakti se që nga ajo ditë kushdo prej nesh si në cilësinë e pozicionit të punës dhe si në aspektin njerëzor është marrë me atë rast ashtu siç jemi marrë me çdo rast tjetër. Në këtë Kuvend jam deputete për herë të dytë dhe mund t'ju them se kemi ndërmarrë nisma për ndryshimin e Kodit Penal sa i takon ashpërsimit të dënimeve për këto lloj veprash; kemi ndryshuar ligjin për mbrojtjen nga dhuna, duke vendosur masat e mbrojtjes së menjëhershme për dhunuesit menjëherë nga Policia e Shtetit; kemi kryer me një rrjet shumë efektiv të Aleancës së Grave Deputete një sërë nismash, eventesh si në aspektin edukues edhe në atë monitorues; kemi punuar me bashkitë për të forcuar mekanizmat e referimit të dhunës,

për mbrojtjen e fëmijëve dhe të viktimave; kemi bërë ato që janë parë, por kemi bërë edhe shumë nga ato që nuk janë parë.

Jemi marrë me viktimat shumë herë dhe nuk kemi dashur të bëjmë shou, sepse kjo nuk është çështje për politikë, sepse këtu nuk i vihet dot gishti askujt, këtu të gjithë nuk kanë bërë sa duhet dhe do të vazhdojnë të mos bëjnë sa duhet nëse nuk e problemin në radhë të parë të vetja, sepse të gjithë kemi përgjegjësinë tonë. Gjithçka që kemi bërë duket që është e pamjaftueshme dhe të gjithë duhet të bëjmë më shumë, duke filluar që nga monitorimi për zbatimin efektiv të ligjeve që kemi, nga rritja e përgjegjësisë së institucioneve, të cilat janë ligjzbatuese dhe duhet të ushtrojnë detyrat e veta, por edhe vetë shoqëria duhet të jetë shumë herë më e ndjeshme. Ashtu sikurse kërkojmë që gjyqtarët, së bashku me prokurorët, të kenë ndjeshmëri dhe kujdes në vendimet që japin, duke marrë në konsideratë çdo rrethanë të çështjes, padiskutim mbajnë përgjegjësi dhe duhet të jenë të kujdesshëm në këtë drejtim, ashtu duhet që edhe institucionet ligjzbatuese të jenë më efektive në zbatimin e rasteve të konsideruara të rrezikshme, ashtu si edhe vetë bashkitë apo institucionet vendore, por nga ana tjetër edhe vetë qytetarët duhet të jenë më sensitivë.

Jo çdo gjë që ndodh në një komunitet mund të jetë e parandalueshme, por shumë raste mund të jenë të parandalueshme. Po ju them vetëm një shembull, shumë qytetarë ankohen menjëherë për një ndërtim pa leje apo për një parkim të kundërligjshëm dhe menjëherë institucionet e rendit janë aty. A nuk mundemi të jemi të gjithë ne, si qytetarë, ata që edhe tregojnë në organet përkatëse rastet e rrezikut në komunitet tona, sepse kjo është një luftë e të gjithë shoqërisë? Nuk duhet ta përdorim këtë për një betejë politike ose për të treguar se dikujt i dhemb më shumë ose më pak. Jo, në fakt, unë mendoj se këtu na dhëmb të gjithëve. Ajo që ne duhet të bëjmë është se ne si komision përgjegjës, duke pasur mekanizma dhe mjete në këtë Kuvend, duhet t'i përdorim dhe gjithsekush nga ne të vijmë me propozime efektive si mund të bëjmë më shumë. Por nuk mendoj se kjo është një çështje, që mund të zgjidhet me një dëgjësë. Kjo kërkon një plan veprimi, siç ka pasur në legjislaturën e kaluar.

Unë, me sa jam në dijeni, me urdhër të Kryetares së Kuvendit, kanë nisur ftesat për konstituimin e grupit "Miqtë e Fëmijëve" dhe të Aleancës së Grave, të cilat në bashkëpunim me nënkomisionet përkatëse duhet të miratojnë planin e veprimit përkatës. Atje jemi të ftuar të gjithë të kontribuojmë. Kështu që, për këtë çështje, me gjithë sesivitetin që duhet të ketë, pa diskutim, sado që ne të diskutojmë në këtë mbledhje, pavarësisht se kemi rend tjetër dite, çështjet nuk do t'i zgjidhim dot, por duhet t'i bëjmë konkretisht. Gjithsekush nga ne duhet të marrë pjesë, sipas rolit që ka në strukturat përkatëse, edhe në komisione me nisma ligjore, me propozim për monitorim, dhe ne t'u dedikojmë kohë dhe efektivitet këtyre çështjeve.

Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Felaj.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Unë besoj se në këtë pikë ne nuk kemi nevojë të bëjmë as politikë dhe as t'i bëjmë moral njëri-tjetrit, madje përdorimi politik i ngjarjeve të tilla ose të ngjashme duhet të marrë fund jo nëpërmjet deklarimeve politike, por ndërmarrjeve të veprimeve konkrete. Ky komision, në fakt, ka çfarë të bëjë për të reflektuar në parandalimin e rasteve të tilla. Nga shoqëria civile këtë herë, që prej shkurtit të këtij viti, ka nisur përpjekja për mbledhjen e 222 mijë e 428 nënshkrimeve për depozitimin e një iniciative ligjore, që ka të bëjë me një projektligj “Për propozimin e projektligjit “Për krijimin e regjistrit kombëtar të autorëve të krimeve seksuale”. Ky projektligj, që është depozituar në Kuvend, është futur në kalendarin e punës dhe ne si komision mund ta sjellim në shqyrtim në kohë sa më të shpejtë, duke siguruar që çdo anëtar i komisionit të ketë kopjen e projektligjit dhe relacionin përpara, të plotësojmë atë që mundemi dhe të thërrasim të gjithë njerëzit, që mund të ndihmojnë në përmirësimin e këtij projekti.

Personalisht nuk jam për një regjistër, që të përmbajë vetëm të dhënat e autorëve të krimeve seksuale ndaj fëmijëve, por të të gjithë autorëve të veprave penale, ku viktimat janë fëmijët, ose ku përdoren fëmijët, madje edhe ato të dhunës familjare. Është shumë e rëndësishme të kemi reflektim në këtë pikë, që do ta bënte punën tonë dhe të të gjithëve serioze. Ne reaguim më të parë e kemi si qytetarë dhe pastaj si politikanë. Si politikanë e kemi në raport me punën konkrete që jemi përzgjedhur të bëjmë. Ne jemi përzgjedhur të jemi anëtarë të këtij komisioni dhe ky komision ka për detyrë të propozojë, të diskutojë dhe të miratojë ligje që vihen në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut. Kështu që, unë do t'ju ftoj për të këtë dhe nuk vë në dyshim vullnetin e mirë të askujt në këtë komision.

Sa u takon reagimeve personale, ato të tilla do të mbeten dhe sa kohë janë personale, nuk mund të imponohen në këtë pikë.

Këto ngjarje patjetër që kanë ndodhur, për ngjarje të tilla nuk ka si të jesh indiferent. Por në fund të ditës ajo që vlen është reagimi përtej emocioneve, reagimi i ftohtë me arsye, i cili në fakt vendos në praktikë njëherë e mirë. Këtu dua të përmend që edhe zonja Xhixho i është bashkuar kësaj nisme.

Unë po lexoja projektligjin që është depozituar në komisionin tonë nga Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, shoqata “Rrjeti i fuqizimit të gruas në Shqipëri” dhe Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim. Realisht, kjo është një ide që nuk është hedhur tani, por që në vitin 2011, por ka ardhur koha ta bëjmë realitet.

Klotilda Bushka – Po, zonja Felaj, janë dy nisma, në fakt, në Kuvend, është kjo nismë që vjen nga 22 mijë zgjedhës dhe një nismë e propozuar nga zonja Xhixho dhe që, në fakt, janë futur në kalendarin e Kuvendit të kësaj periudhe. Të hënën do të miratojmë kalendarin e komisionit dhe do të jenë të dyja me përparësi.

Është bërë gati, zonja Xhixho, ky kalendar dhe është koha që kjo çështje të trajtohet, sepse kjo çështje ka që në vitin 2011 që shtrohet dhe tani i ka ardhur koha.

Unë ju falënderoj ju dhe 22 mijë zgjedhësve shoqata, të cilat kanë sjellë nisma, që janë për momentin të duhurat!

Zonja Xhixho.

Erisa Xhixho – Faleminderit!

Ju falënderoj për vlerësimin e kësaj iniciative! Jemi shumë të vonuar, ka që në 2013-ën që është paraqitur ky draftide. Ky ligj dhe ky propozim i shoqërisë civile, me shumë ndjeshmëri, ka vite që qarkullon në duart e politikanëve dhe më vjen mirë që në fund kemi një dakordësi. Në momentin që ka ngjarje dhe ligje, të cilat përbëjnë interes publik, besoj se ngjyrat e partive politike i tejkalojnë.

Është një regjistër i domosdoshëm, në këndvështrimin tim, i mungon legjislacionit shqiptar, është një masë e konventave europiane të të drejtave të njeriut, të fëmijëve në veçanti të Këshillit të Europës. Më vjen mirë që, pas iniciativës dhe dorëzimit në parlament të këtij projektligji, i cili ka qenë në bashkëpunim me CRCA-në, e cila është një qendër që mbron të drejtat e fëmijëve, kjo projektide është konsultuar. Më vjen mirë që pas asaj iniciative 20 mijë zgjedhës e kanë depozituar një nismë të tillë, që do të thotë se ne kemi një produkt shumë të mirë mbi të cilin mund të punojmë për të prodhuar një ligj, i cili i shërben shoqërisë në këto momente tragjike dhe tronditëse me të cilat jemi ballafaquar këto kohët e fundit.

Unë mendoj se bërja e këtij regjistri dhe monitorimi i këtyre individëve, monstra do t'i quaja unë, të cilët cenojnë sigurinë publike të fëmijëve, të grave dhe të vajzave do të jetë sukses dhe nder i këtij Kuvendi. Por duhet që të monitorojmë edhe implementimin e këtij ligji. Është detyrë e këtij parlamenti që të monitorojë edhe implementimin, që të jetë sa më efektiv dhe t'i shërbejë betejës që ne kemi ndaj dhunës në familje dhe akteve të tilla çnjerëzore.

Më vjen mirë që marr lajmin sot që do të jetë pjesë e punimeve të komisionit. Ka pika të përbashkëta midis dy drafteve, ka edhe pika ku ne ndahemi, ndaj do të jetë shumë mirë që ne të bëjmë një debat për të marrë eksperiencat më të mira të BE-së, ose SHBA-ve, pasi ky legjislacion i cili është i aplikuar në Maqedoninë e Veriut, Anglia ka 25 vjet që e ka, është shumë mirë që edhe ne ta kemi pjesë të korpusit ligjor këtë ligj.

Faleminderit!

Klotilda Bushka - Ne menjëherë do t'i fusim në kalendar të dyja nismat. Me të gjitha diskutimet, marr spunto edhe nga diskutimi i sotëm, në kuadër të përmirësimit ose amendamenteve që do të jenë në këto dy nisma, ne do të japim kontributin tonë direkt.

Unë mendoj të vijojmë me rendin e ditës. Kjo çështje është e ezauruar dhe javës tjetër do ta diskutojmë. Të mos e kthejmë në politikë, sepse është një çështje sensitive. Kemi detyrë si qytetarë të jemi të kujdesshëm. Kështu që, zoti Sula do t'jua jap vetëm ju fjalën dhe do të kalojmë të rendi i ditës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Enkelejd Alibeaj – Zonjë kam kërkuar fjalën për procedurë, bëra dhe një kërkesë, nuk mora asnjë lloj përgjigjeje...

Enkelejd Alibeaj – Mbaje shtypur atë, sepse kjo nuk është mënyra normale për të diskutuar në lidhje me një çështje, që s'është aspak politike. Nuk është politike, e mbi të gjitha është njerëzore. Është njerëzore. Të paktën në këtë moment kemi vetëm fjalën. Fjalën kemi. Unë bëra një kërkesë. Nuk është për politikë. Kërkesa ime ishte për të parë një reagim, pa asnjë lloj dallimi politik. Realisht, nuk e kuptoj se përse ju do të duhet të futeni menjëherë në pozicion mbrojtës. Jo, nuk është kjo. Këtu do të duhet të reagojë organi më i lartë, që është parlamenti, në lidhje me një çështje që prek të gjithë shoqërinë. Jo vetëm çështja e izoluar, jo vetëm ajo, ajo po e po, por bëhet fjalë edhe për të ardhmen.

Tani, të them të drejtën, jam dakord.

Çfarë projektligji ishte, zonja Felaj? Po. Dakord. Shumë mirë. Por nuk është e udhës që parlamentarët, Parlamenti i Republikës të ngrejë duart lart dhe të thotë: unë po bëj një projektligj, dhe këtu ka mbyllur misionin dhe detyrën. Jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky parlament ka minimalisht, me kompetencat që i jep Kushtetuta atyre institucioneve ekzekutive nga njëra anë, por edhe atyre të sistemit të drejtësisë, brenda kontureve të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, së pari t'u kërkojë informacion KLGJ-së, KLP-së, ILD-së, të gjitha atyre institucioneve. Pra, informacion, kambanë, që siç duhet të reagojë ky parlament, edhe ato institucione të tjera të reagojnë, për të kuptuar nëse problemi i vetëm është pse ka munguar një projektligj, apo se kemi projektligje, por ato nuk miratohen.

E tha me të drejtë zonja Xhixho: po miratojmë ligjin, por kemi merakun se si do të zbatohet. Po, e tha zonja kryetare: kemi bërë ndryshime në Kodin Penal. Hë pra, paskeni bërë ndryshime në Kodin Penal, por nuk funksionon. Tani duhet të shohim nga vetja: e kemi kontrolluar ne se si ka ecur çështja e zbatimit të Kodit Penal apo jo? Nëse e kemi kontrolluar, atëherë duhet të shohim se nuk është problemi te ligji, por tek institucionet, tek institucionet.

Këtu nuk mund të rrimë të heshtur, nuk mund ta kalojmë këtë çështje me idenë se pas tri ditësh do të ndodhë një tjetër ngjarje e rëndë, e cila do t'i mbivendoset kësaj. Nuk është kjo mënyra. Ju thashë: nuk dua dhe s'ka se si të pozicionohemi ju andej e ne këndeje, pavarësisht se ka një dallim. Ju jeni maxhoranca, keni miratuar qeverinë, keni qeverisjen që prej tetë vjetësh. Kohë e mjaftueshme. E megjithëkëtë, s'po dua të vendos mure ndarëse për ta kthyer në luftë politike. Absolutisht jo. Po ama, një reagim në mënyrë integrale të parlamentit, organit më të lartë të atyre njerëzve do të duhet ta kemi. Kujt duhet t'ia kërkojmë? Sigurisht qeverisë. Ajo e ka për detyrë parandalimin, e sigurisht pastaj edhe marrjen e masave atëherë kur ndodh ngjarja. Nuk mund të shndërrohet shteti thjesht e vetëm në një institucion, që lëshon pika loti kur ngjarja ndodh, me fytyrë të vrerosur, dhe çon si epitaf një projektligj.

Jo, nuk është kështu. Nuk duhet të jetë kështu. S'duhet ta tolerojmë këtë situatë. Duhet të mendojmë edhe për ngjarjet që mund të vijnë në të ardhmen. Ju thashë: ata njerëz që çanë sot dyert e gjykatës, kanë frikë për familjet e tyre, për fëmijët e tyre, siç duhet ta ketë gjithësecili, të themi të drejtën, fatkeqësisht, në këtë vend. Duhet ta ketë. Minimalisht, duhet ky reagim. Kaq ishte. Nuk ishte për asgjë më tepër. S'mund ta kalojmë buxhetin: neni 1, neni 2, neni 3.

Klotilda Bushka – Dakord!

Enkelejd Alibeaj – Është e pahijshme për këdo në aspektin njerëzor, e pastaj edhe në atë politik.

Klotilda Bushka – Dakord, zoti Alibeaj! Ne biem dakord të gjithë, që po. të gjithë kemi mundësi të bëjmë edhe më shumë, por konkretisht do të duhet të bëjmë më shumë. Nuk janë reagimet ato që i zgjidhin situatat. Reagim ka pasur nga Kryetarja e Kuvendit, ka pasur nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, ka pasur nga ne si kryetarë komisionesh. Çështja është çfarë bëjmë. Pra, kemi bërë shumë veprime, kemi bërë dhe ligje, kemi bërë dhe monitorim. Diku çalon, pra. Atëherë, ejani të mblidhemi të gjithë së bashku. A doni të bëjmë një reagim të përbashkët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Doni të bëjmë një reagim të përbashkët? Të ulemi ta shkruajmë? Dakord. Doni të thërresim në dëgjuesë institucione?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulemi dhe i thërresim. Doni t'u kërkojmë llogari institucioneve? Ejani ta bëjmë, por me propozime konkrete.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk do ta zgjidhim në këtë sekondë. Jam shumë dakord. Kjo është një çështje që na takon të gjithëve, por na duhet të veprojmë konkretisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne përmendëm rastin e ligjit, sepse tashmë ky rast është i freskët, por ka shumë veprime të tjera, që ne mund të bëjmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Sula, do t'jua jap fjalën edhe juve, dhe ju pres nga secili koleg veprime konkrete që ne duhet të ndërmarrim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Gogo, zoti Nallbati...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk na shkon të bëjmë një debat të tillë tani.

Për ta mbyllur, zoti Sula, do t'jua jap fjalën edhe juve. Për ta mbyllur, unë do t'ju kërkoj të gjithë kolegëve të këtij komisioni, që të më sjellin propozime konkrete në lidhje me çfarë mendoni se mund të bëjmë më shumë për këtë situatë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të bëjmë ndryshime në ligj, mund të bëjmë monitorim, mund të bëjmë veprime konkrete. Unë jam e para, që së bashku me ju, të jem pjesë e nismave të përbashkëta.

Tani, zoti Sula, fjala për ju.

Dashnor Sula – Kryetare...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kryetare...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po lëre tani, se s'ka kuptim!

Klotilda Bushka – Zoti Nallbati, ju lutem!

Zoti Sula, fjala për ju!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Sula, a do ta merrni fjalën?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

U bëj thirrje kolegëve, që të ruajnë qetësinë, se edhe ne jemi shembull tek të tjerët për maturi. Të gjithë kolegëve u bëj thirrje për maturi dhe qetësi. Ju lutem, kolegë!

Zoti Sula ka kërkuar fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dashnor Sula – Toni, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit, zonja kryetare!

Klotilda Bushka – Vazhdo, zoti Sula!

Dashnor Sula – Nuk kisha ndërmend ta merrja fjalën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

O Bledion!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lëre pra fjalën tani!

Klotilda Bushka – Zoti Nallbati, ju tërheq vëmendjen! Ju lutem, mbani qetësi dhe dëgjoni kolegun Sula.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Nallbati!

Të gjithë kolegëve u kërkoj të vetëpërbahen. Ju lutem!

Zoti Sula, merreni fjalën, sepse jua kam dhënë. Unë e kuptoj se ju doni të qetësoni kolegët, por më mirë vazhdoni, se ndërkohë që flisni, mbase ju respektojnë dhe ju dëgjojnë.

Dashnor Sula – Sigurisht, ngjarja është e dhimbshme. Pa diskutim që dhimbja është jashtëzakonisht e madhe për familjarët, por edhe për pjesën e shëndoshë të shoqërisë, që kjo ngjarje i ka prekur dhe tronditur thellë. Në të njëjtën kohë, do të thosha se është e turpshme për të dy krahët e politikës apo për atë pjesë të dobët të shoqërisë, ku hipokrizia është në një shkallë jashtëzakonisht të lartë.

Këtu nuk është nevoja të përmendim emra, se cilët janë në të djathtë apo në të majtë, cilët janë politikanë dhe cilët personalitetet, që hipokrizinë e kanë në majë të buzës, do të thosha, në kuptimin që, ditën kur ndodh një ngjarje, se kjo s'është ngjarje e parë, qoftë kjo që rezulton me humbjen e jetës së këtij fëmije të pafajshëm, qoftë edhe mjaft ngjarje të tjera tronditëse, duke përfshirë sidomos dhunimin e vajzave apo o grave shqiptare. Ne jemi dëshmitarë të këtyre ngjarjeve mjaft tronditëse dhe në çastin që ndodhin këto ngjarje të gjithë marrin një pozicion, duke u justifikuar apo duke treguar keqardhje.

Fatkeqësisht, si dje apo sot kur jeni ju në maxhorancë, pas 3 ditësh ngjarja harrohet dhe reagimi i organeve përgjegjëse për këtë gjë fillon e zbehet.

E them këtë, duke pasur parasysh se ka disa momente kur qeveria apo institucionet duhet të reagojnë.

Siç e thanë zoti Alibeaj apo zonja Xhixho, ka të bëjë parandalimi, hetimi, ndëshkimi dhe rehabilitimi.

Të gjithë jemi dëshmitarë që mungesa e kujdesit apo e korrektësisë në përmbushjen e detyrave nga organet e parandalimit, që, në radhë të parë, është Policia e Shtetit, e cila ka detyrë të kontrollojë çdo pëllëmbë të territorit të Republikës së Shqipërisë apo t'i parandalojë ngjarjet e rënda, lë shumë për të dëshiruar. Kjo gjendje nuk është e sotmja, por ka qenë edhe e djeshmja, por, për shkak të drejtuesve politikë apo drejtuesve të policisë, ka momente kur këto ngjarje shpërthejnë për shkak sepse derivojnë nga mbështetja e politikës dhe për këtë duhet të jemi dëshmitarë të ngjarjeve të caktuara.

Kemi parasysh se ka pasur edhe raste të caktuara, si për shembull në Durrës, në Elbasan, në Krujë, në Lezhë apo në Shkodër, kur janë involvuar të gjithë elementët politikë për të bërë të mundur që denoncueset femra të tërheqin denoncimet. Këto ngjarje kanë qenë mjaft të trishtueshme dhe ne jemi dëshmitarë të gjallë dhe i dimë të gjitha këto gjëra.

Zonja kryetare, unë mendoj dhe gjykoj që, vërtet ne sot diskutojmë në këtë seancën e buxhetit që është shumë e rëndësishme, por janë më të rëndësishme ngjarjet që ndodhën dhe ne duhet të kemi një reagim unifikues, të majtë dhe të djathtë.

Cila është rruga? Këtu nuk është problemi se Shqipëria nuk ka ligje, nuk është problemi se nuk ka nisma, por problem është zbatimi i këtyre ligjeve, pra këto ligje duhet të zbatohen nga institucionet përkatëse, dhe kontrolli që duhet të bëhet.

Hetimi lë shumë për të dëshiruar, qoftë nga Policia Gjyqësore, qoftë nga organi i Prokurorisë, qoftë nga gjykata që bën dënimin. Pse? A ka dënime maksimale? Është e trishtueshme sot kur shikon që pjesa më e madhe e shoqërisë kërkon rikthimin e dënimit me vdekje. Është e trishtueshme, dhe kjo ndodh se nuk kanë besim te drejtësia; ndodh sepse kriminelët më të mëdhenj, të cilët mund të marrin dënimin 25 vjet apo burgim të përjetshëm, pas 15 vjetësh i shohim jashtë burgjeve. Këto janë fakte. Janë dhjetëra kriminelë të dënuar me burgim të përjetshëm që nga ngjarjet e '97-ës apo më pas, të cilët sot gëzojnë lirinë dhe këto elemente kriminale organizojnë përsëri banda. Ky është një problem mjaft i madh. Kjo ndodh nga moszbatimi i ligjit nga institucionet përkatëse.

Unë mendoj se ky vend, ky parlament, duhet të ushtrojë presionin maksimal, jo kur ndodhin ngjarjet, por çdo muaj nëse ka mundësi, çdo 3 muaj apo 6 muaj apo 1 vit. Duhet të ketë vëmendje më të madhe për të ushtruar presion tek organet ligjzbatuese. Vetëm kjo mund ta shpëtojë këtë vend, sepse në burg, duke filluar nga drejtori i burgut, nga juristi i burgut, nga prokurori i cili ka çështjen e lirimit me kusht, apo gjyqtari bëjnë allishverishe ekstreme dhe ky është problemi më i madh.

Në qoftë se parandalohet, dënohet, ndëshkohet dhe nëse gjykata dhe prokuroria nuk i jep shansin që të shkelë ligjin, sigurisht që do të ketë besueshmëri qytetare. Po u arrit kjo, nuk do të flisnim sot për këto ngjarje.

Unë gjykoj që të majtë dhe të djathtë të mos bëjmë hipokrizi.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Sula!

Ne e kemi këtë mundësi të gjithë së bashku me veprime konkrete, ligje, monitorime, nisma.

Unë ju thashë, dhe besoj se të gjithë biem dakord që të bëjmë çfarë mundemi, edhe më shumë se mundemi. Ne jemi bashkë këtu, kështu që nuk ka nevojë t'i bëjmë moral njëri-tjetrit, sepse kjo është një çështje që na intereson të gjithëve. Gishtin, secili nga vetja.

Urdhëroni, zoti Mediu!

Fatmir Mediu – Nuk kam çfarë të shtoj asgjë në debat, por ajo që më vjen keq është se ne nuk arrijmë të kuptojmë që, po nuk respektoam njëri-tjetrin, nuk respektojmë dot askënd përjashta.

Është mirë që në këtë komision, për kaq pak sa jemi dhe, më që shihemi pothuajse përditë, të vendosim një raport etik në mënyrën se si flasim me njëri-tjetrin.

Unë e gjej me vend shqetësimin e zotit Alibeaj, por edhe shpjegimet që përmendën zonja Felaj apo zonja Xhixho, që janë të mjaftueshme për të arritur të kuptojmë se ç' duhet të bëjmë.

Si deputetë, ne kemi të gjithë autoritetin për të kërkuar iniciativa ligjore për të bërë atë që është më e mira. Kështu që, për të mos e shtuar dhimbjen apo këtë situatë, duhet të lëmë mënjane retorikën, sepse nuk bëjmë asgjë të mirë, përveç se fillojmë dhe ulim autoritetin politik apo institucional, qoftë edhe tonin si individë duke bërë debate pa fund, sidomos kur ato janë jashtë standardit.

Do t'ju lutesha të krijojmë një raport të mirë dhe për ta bërë këtë, zonja kryetare, kam një propozim që për çështje jashtë rendit të ditës të ketë një diskutim ku secili të shprehë mendimin e vet dhe e mbyllim aty, ose, në rastin më të mirë, ngrihet një shqetësim nga opozita, ka një reagim nga maxhoranca dhe e mbyllim me një propozim konkret se si duhet proceduar.

Ky është mendimi im.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Mediu!

Në fakt, është shumë e drejtë, por duhet të biem të gjithë dakord dhe besoj se jemi të gjithë dakord.

Atëherë, shumë faleminderit kolegë për debatet!

Uroj të bëjmë shumë më shumë se ç’kemi bërë për të qenë efektivë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut! Shpresoj që ky debat të jetë konstruktiv dhe të ketë rezultat për të ardhmen!

Vijomë me rendin e ditës.

Çështja e parë është miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datës 26 tetor dhe 1 nëntor.

A jemi dakord të gjithë? Dakord.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për buxhetin e shtetit”.

Zoti Bllako është relatori.

Urdhëroni, zoti Bllako!

Alqi Bllako – E nderuar kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në mbledhjet te datave 5, 8, 9 dhe 11 nëntor zhvilloi disa seanca dëgjimore me institucionet e pavarura kushtetuese dhe institucionet e pavarura të krijuara me ligj, sipas fushës së veprimtarisë, në përgjegjësinë e këtij komisioni.

Pas këtyre dëgjesave dhe pas konsultimeve si me Ministrinë e Financave, ashtu edhe me institucionet përkatëse, pra ato çështje që u lanë si detyrë gjatë këtyre seancave dëgjimore, si relator i këtij komisioni për sa i përket projektbuxhetit të vitit 2022, referuar kërkesave të institucioneve, por edhe mundësive buxhetore për t’i mbështetur këto kërkesa, propozoj si më poshtë vijon për të marrë më pas miratimin ose jo të anëtarëve të këtij komisioni.

Për projektbuxhetin e Gjykatës Kushtetuese nuk po ndalem në detaje për të ripërsëritur edhe një herë tavanet buxhetore të çdo institucioni, por po fokusohem te propozimi specifik për shtesa, ose ndryshime në zërat buxhetorë për çdo institucion.

Për projektbuxhetin e Gjykatës Kushtetuese, në përfundim të diskutimeve, propozoj që Komisioni i Ligjeve t’i propozojë komisionit përgjegjës shtesën në zërin e shpenzimeve kapitale në vlerën 15 milionë lekë për këtë institucion. Më pas detajimi i këtyre zërave do të bëhet nga vetë institucioni me detajimin përkatës buxhetor.

Për sa i përket projektbuxhetit për Prokurorinë e Përgjithshme, pas diskutimeve me këtë institucion dhe me Ministrinë e Financave propozimi paraprak ishte të kishte një shtesë të numrit të punonjësve për OPGJ-të, 10 punonjës çdo vit, duke filluar në periudhën 2022-2024, ndërkohë që propozimi ynë, nisur edhe nga volumi i madh i çështjeve, por edhe nga mungesa e prokurorëve në këtë prokurori, është që shtesa e plotë prej 30 punonjësish të bëhet në vitin

2022, të mos ndahet në 3 vjet buxhetorë dhe kjo t'i propozohet për miratim komisionit përgjegjës së bashku me koston buxhetore përkatëse.

Kalojmë tek projektbuxheti për Shkollën e Magjistraturës. Kërkesa që erdhi nga institucioni u dakordësua dhe do t'i përcillet komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, është mundësia për ta riparë buxhetin gjatë gjysmës së dytë të vitit 2022 për akomodimin e të gjitha nevojave që lidhen me pagesën e pagave të ekspertëve dhe pedagogëve të programeve formuese të shkollës, duke qenë se në këtë moment nuk janë në gjendje për të përlllogaritur një vlerë të nevojshme për këtë gjë, si dhe t'i kërkojmë komisionit për Ekonominë të planifikohet për vitin tjetër fondi i plotë i nevojshëm për të çelur garën për ndërtimin e godinës së re të Shkollës së Magjistraturës në vlerën 576 milionë lekë që është te Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Për sa i përket projektbuxhetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i propozoj këtij komisioni, në bazë të diskutimeve edhe me përfaqësues të Këshillit të Lartë Gjyqësor, financimin e hartimit të projektzbatimit për ndërtimin e Gjykatës së Lartë në vlerën 29 milionë lekë, financimin e hartimit të projektzbatimit për ndërtimin e gjykatës së Tiranës në vlerën 38 milionë lekë dhe financimin e sistemit të ri elektronik për menaxhimin e çështjeve gjyqësore një projekt, i cili shkon në 443 milionë lekë në tërësinë e tij, i ndarë në 2 vjet buxhetore. Ndaj shtesa e propozuar për vitin 2022 është 100 milionë lekë, në mënyrë që KLGJ-ja të fillojë procedurat për implementimin e këtij sistemi.

Për sa i përket KLP-së, nuk kemi asnjë kërkesë për fonde shtesë, referuar këtij institucioni. Zotërinjtë përfaqësues të këtij institucioni në këtë komision shprehën dakordësinë e tyre me tavanet buxhetore të propozuara nga Këshilli i Ministrave për Kolegjin e Posaçëm të Apelit. Propozohet shtesa në zërin për “pagat dhe sigurimet shoqërore” në vlerën 93 milionë lekë, i propozohet për shqyrtim dhe miratim komisionit përgjegjës për Ekonominë, pasi fondi i parashikuar, sipas kërkesave të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, është i pamjaftueshëm për mbulimin e plotë të nevojave të personelit, ndërkohë kërkesa për sa i përket mirëmbajtjes së godinës, që u dakordësua edhe në seancën dëgjimore, akomodohet lehtësisht në zërin “shpenzime operative” të Ministrisë së Drejtësisë, duke qenë se është dhe ministria, e cila ka në pronësi dhe administron këtë godinë.

Për sa i përket Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, propozohet shtesë në zërin “paga dhe kontributeve shoqërore” për të plotësuar nevojat e këtij institucioni, pra të funksionit që ka ky institucion pavarësisht se kush do ta kryejnë këtë funksion gjysmën e dytë të vitit 2022, në vlerën 54,682 milionë lekë, ku respektivisht 50 milionë lekë shtesë në zërin e pagave dhe 4,682

milionë lekë në zërin e kontributeve shoqërore. Propozohet dhe shtimi në zërin “investime” në vlerën 3 milionë lekë.

Për sa i përket institucionit të Komisionerëve Publikë, nuk u parashtrua asnjë kërkesë shtesë të fondeve buxhetore. E njëjta situatë edhe me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Për projektbuxhetin e strukturës së posaçme antikorrupsion propozoj që komisioni ynë t'i propozojë Komisionit përgjegjës për Ekonominë një shtesë në zërin e mallrave dhe shërbimeve në vlerën 20 milionë lekë, që do të përdoren kryesisht nga Byroja Kombëtare e Hetimit, si dhe një shtesë në zërin e investimeve në vlerën 10 milionë lekë, siç u dakordësua në seancën dëgjimore në këtë komision.

Për sa i përket institucionit të Presidentit të Republikës, propozoj shtesën e kërkuar në tërësi për dy vjetët buxhetorë 2022-2023 në vlerën 36 milionë lekë për projektin që u paraqit dhe u dakordësua në këtë komision, ndërkohë që shtesa e propozuar për vitin 2022 për këtë projekt është në masën 10 milionë lekë.

Institucioni i ILDKP-së nuk paraqiti asnjë kërkesë për fonde shtesë, duke shprehur dakordësinë për tavanet e propozuara dhe të miratuara.

Për projektbuxhetin e KQZ-së propozohet shtesë fondi në vlerën 150, 751 milionë lekë në zërin “shpenzime kapitale” për rinovimin e dhomës së serverëve, magazinën, e cila është djegur plotësisht, pajisjet informatike dhe pajisje për kopjimin e memorieve USB në paralel, të cilat u konsideruan të domosdoshme për vazhdimin e aktivitetit të këtij institucioni, si dhe shtesën në vlerën 8,845 milionë lekë në zërin “shpenzime korrente” për hapjen e kutive të votimit.

Për projektbuxhetin e Avokatit të Popullit shtesa e propozuar për miratim nga ky komision, më pas për t'ia përcjellë Komisionit përgjegjës për Ekonominë është në vlerën 3 miliardë e 946,108 milionë lekë në zërin “paga dhe sigurime shoqërore”, nga të cilat 1 milionë lekë do të jetë një transfertë e brendshme nga zëri i transfertës për buxhet familjar, ndërkohë që 2 milionë e 946 e 108 lekë do të jetë shtesë në buxhet.

Kemi dhe një propozim për një rialokim të brendshëm në zërat e këtij institucioni, ku propozohet shtimi në zërin e investimeve me 2 milionë lekë dhe pakësimin i po të njëjtës vlerë në zërin “shpenzime operative”. Besoj se gjetëm dakordësinë e institucionit në seancën dëgjimore.

Për sa i përket Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, propozohet një rialokim nga zëri “shpenzime operative” te zëri “investime” në vlerën 2 milionë lekë që u dakordësua edhe gjatë seancës dëgjimore.

Për projektbuxhetin e Komisionerit për të Drejtën e informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, komisionit përgjegjës i propozohet akordimi i një fondi shtesë i ndarë në 2 vjet buxhetorë 2022-2023 për realizimin e projektit të regjistrit elektronik të thirrjeve të pakërkuara. Në total projekti kap vlerën e 11 milionë lekëve, i cili do të ndahet në 2 vjet buxhetorë dhe shtesa e propozuar për vitin 2022 është në masën 5,5 milionë lekë.

Për sa i përket Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, propozohet miratimi i kostove përkatëse buxhetore për të përballuar shtesën në strukturë me 2 punonjës të këtij institucioni. Propozoj që t'i përcillet për miratim komisionit përgjegjës.

Për sa i përket projektbuxhetit të Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit, propozoj që komisionit përgjegjës t'i shkojë propozimi nga ana jonë për shtesën në zërin “ investime të huaja” që më së shumti ishte një lapsus, një haresë, ishte një fond i parashikuar në këtë vit buxhetor i padisbursuar, i cili duhet të transferohet në vitin e ardhshëm buxhetor në masën 67, 2 milionë lekë, rrjedhimisht duhet të shoqërohet edhe me një shtesë në zërin e TVSH-së prej 10 milionë lekësh, që shoqëron këtë projekt. Shtesa e propozuar për zërin “shpenzime për mallra dhe shërbime” për të jetësuar atë kalendar të rëndësishëm aktivitetesh që zonja Sula paraqiti pranë këtij komisioni, propozohet një shtesë në masën 15 milionë lekë, si dhe plotësimi i nevojave, pasi kishte një deficiencë në këtë pikë për zërin e pagave dhe kontributeve në vlerën 10 milionë lekë.

Për projektbuxhetin e Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, siç u diskutua edhe në dëgjuesën me institucionin në fjalë, propozohet shtesa në zërin e pagave dhe kontributeve në vlerën 5 milionë lekë, si rregullim i pasaktësisë së bërë në përlllogaritjen e këtij fondi.

Për sa i përket Komisionit të Prokurimit Publik, shtesa e propozuar lidhet me financimin e projektit të dixhitalizimit të ankesave në vlerën 24 milionë lekë.

Për Ministrinë e Drejtësisë, nga kjo ministri nuk kishim asnjë kërkesë për fonde shtesë.

Ndërkohë, për sa i përket projektbuxhetit vendor, unë propozoj të përfshijmë në relacionin për shqyrtim dhe miratim në Komisionin përgjegjës për Ekonominë dhe Financat të gjitha propozimet që erdhën nga shoqatat, të cilat u dëgjuan në këtë komision. Nuk është tagër i këtij komisioni të miratojë ndryshimet specifike që u propozuan këtu, por, pa diskutim, ne do t'i sugjerojmë komisionit përgjegjës që t'i marrë në shqyrtim dhe në konsideratë propozimet e ardhura nga shoqatat respektive. Gjithashtu, ka një propozim të ardhur me shkrim, faktikisht, nga Shoqata e Këshillave të Qarqeve, i cili do t'i përcillet komisionit përgjegjës, ku propozohet parashikimi i një buxheti të dedikuar për këshillat vendorë,

përkatësisht këshillat bashkiakë, i cili të përdoret në përmirësimin e infrastrukturës së këtyre këshillave.

Në përfundim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, këshillat e qarqeve.

Komisioni vendosi ose, më saktë, unë propozoj që komisioni ynë t'i propozojë Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat miratimin e shtesës së kërkuar për akomodimin e kërkesave të pushtetit vendor, që lidhen me detyrime specifike, që rrjedhin nga ligji për sa u përket subvencioneve të parashikuara në ligj apo detyrimeve kontraktore me mbështetje buxhetore të iniciuara, të cilat nuk janë parashikuar në buxhetin respektiv.

Këto ishin pak a shumë në mënyrë të përmbledhur të gjitha propozimet që unë bëj në rolin e relatorit, pas diskutimeve, siç u la detyrë në këtë komision, me institucionet përkatëse, por, sigurisht, edhe me Ministrinë e Financave.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Bllako!

Në fakt, këto janë çfarë dolën gjatë dëgjësave. Ne i diskutuam paraprakisht, por në qoftë se kolegët kanë ndonjë gjë për të shtuar, mund të shprehen.

Fjalën e ka zonja Dhurata... T'ia jap një herë fjalën zonjës, se ka një pyetje, apo nuk ka gjë? The që ke pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zgjidheni.

Fjalën e ka zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Tani, zonjë, ti ruaj radhën si të duash, por nuk është se të bën nder ideja që të kalosh sa andej-këndej, qoftë për të qenë edhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përfaqësojmë edhe zërin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mllefim e shprehni ju në çdo pikë...

Xhemal Qefalia – Duhej t'ia lije zonjës fjalën, për etikë.

Enkelejd Alibeaj – ...edhe atje ku nuk është vendi.

Klotilda Bushka – Ju lutem, vazhdojmë.

Enkelejd Alibeaj – E vërteta të bën të lirë, ka thënë dikush, mos iu fshihni asaj.

Tani, lidhur me propozimet e bëra nga relatori, të cilat i ndoqa me kujdes, por besoj se ka pasur edhe sy e veshë të tjerë për t'i ndjekur me kujdes për atë që është akti i fundit, me të

cilin nuk zhgënjyet lidhur me projektbuxhetin në vitin 2022, testi i vetëm që ka pasur ky komision dhe më pas edhe ky Kuvend ka qenë raporti që krijon me institucionet e pavarura, se për institucionet e ekzekutivit ju bëni dhe nuk pyesni askënd tek e fundit. Por me institucionet e pavarura ka një raport tjetër, atë të cilin unë e kam përmendur edhe në seancat e dëgjësive me këto institucione të pavarura, dhe raporti duhet të jetë kushtetues, ato kërkojnë, parlamenti, jo qeveria, iu plotëson kërkesat.

E vetmja gjë që parlamenti, për shkak të supremacisë së pozicionit që ka në raport me to, është të akordojë dhe të analizojë kërkesat në bazë të performancës: sa performojnë, aq edhe duhet t'u jepet. Në fakt, aq edhe duhet t'u kërkojnë. Kjo ruan pavarësinë dhe llogaridhënien sipas parimit të ndarjes dhe të balancës së pushteteve. Çfarë ndodh këtu?

Po ju marr thjesht vetëm një shembull për të kuptuar se çfarë ndodh me paratë e shqiptarëve. Kjo qeveri, jo ky parlament, se ky i fundit as është fare në refene, edhe fjalën e relatorit e patë, çdo gjë që thoshte, e kishte në referencë nga Ministria e Financave, nga qeveria, pra, ç'përcakton qeveria, noterizohet fare pa dinjitet në këtë parlament, pra shembulli ishte raporti që krijon ky parlament me reformën në drejtësi. A do të duhej të ishte një tjetër marrëdhënie, siç kjo që unë përshkrova pak më parë, raporti midis politikës dhe drejtësisë, ku politika të mos ndërhyjë te drejtësia, të mos e pengojë drejtësinë? Po, kjo ka qenë emblema, shkruar këtu e 5-6 vjet më parë. Dhe në momentin më energjik, kur kjo emblemë "Politika larg duarve nga drejtësia" materializohet te buxheti; njëri prej komponentëve, çfarë ndodhi? Këshilli i Lartë Gjyqësor i ka bërë kërkesë qeverisë për t'i dhënë para dhe staf për të ushtruar një nga detyrat kushtetuese që ky parlament ia ka dhënë 5-6 vjet më parë: vetingun.

Ishin mbledhur, ishin studiuar, kishin analizuar, kishin llogaritur, u duheshin rreth 30 milionë lekë, diku te 27 shtesë në staf, bërë kërkesa, bërë analiza, çuar në Ministri të Financave; zero përgjigje. Vjen ministrja dhe gënjen publikisht në Kuvend. Ministrja që gënjen në Kuvend, nuk do të duhet të shkelë më këtu!

"Nuk kam pasur kërkesë", - tha, "nuk kam asnjëlloj kërkesë". Zonja që kryeson KLGJ-në erdhi, ka bërë kërkesën, e ka bërë edhe me shkrim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë ndodh? Sot vini e na thoni të njëjtën gjë, që ministrja i ka bërë, që qeveria i ka bërë sistemit të drejtësisë. Zero lekë për KLGJ-në për të ushtruar ata një detyrim kushtetues, vetingun. Asnjë para! Rrinë ata me duart lart.

Vjen relatorja dhe thotë: nuk e dimë se ç'do të ndodhë. Ne e dimë ç'do të ndodhë. Është e shkruar. Deri në qershor të vitit 2022 e bën një organ: KPK-KPA-ja. Më pas, e bën KLGJ-KLP-ja.

Kanë kërkuar paratë, kanë kërkuar edhe njerëzit, por ju nuk ua jepni; njëra anë e medaljes. Ana tjetër, Kolegji i Posaçëm i Apelit ankohet se “Nuk kam para”, thotë, se me këto para që më janë dhënë nga buxheti, shkoj deri në shtator të vitit 2022. Në fakt, puna e tyre duhet të vazhdojë edhe më tej. E çfarë bëni ju?

E para, nuk e parashikoni ashtu siç duhet, por me idenë se tashmë maxhoranca ka paraqitur një iniciativë kushtetuese për të ndryshuar Kushtetutën për vetingun e gjyqtarëve, siç doni ju, pra, me ndërhyrje brutale në drejtësi, i harruat të gjitha përbetimet e dikurshme që pasi të miratohej reforma në drejtësi, politika do të kishte zero mundësi të ndërhynte në drejtësi. Pas pesë vjetësh e gjysmë jeni me të dyja duart brenda drejtësisë për ta mbajtur atë nën tutelë. Edhe atyre pak institucione që kanë dëshirën për ta zbatuar reformën në drejtësi, KLGJ-ja në këtë rast, ju ua prisni duart. Disa të tjerë nuk duhet ta bëjnë atë gjë, sepse e kanë me afat këtë mandat, pa prituri fare nëse do të ketë ndonjë ndryshim, do të miratohet apo jo, ju e ecni. Do të thotë që ju keni përcaktuar institucionet e drejtësisë që i pëlqejnë politikës.

Konkluzioni është ky: “Më pëlqejnë një, dy, tre institucione, të cilat i mbështes dhe u jap para, por nuk më pëlqejnë institucionet e tjera të drejtësisë së re dhe nuk i mbështes”. Ky është testi politik që do të duhet të kalonte buxheti në raport me institucionet e pavarura. Kjo ishte prova që duhej të ishte dhënë nga ky Kuvend: “Respektoni Kushtetutën, respektoni pavarësinë e tyre dhe u jepni mbështetje”. Ndërkohë, të gjitha problemet që u parashtruan me gjysmë zëri aty ku është ulur qeveria sot nuk gjejnë asnjëlloj mbështetje.

Parlamenti nuk jep para, ata qahen se drejtësia nuk funksionon, drejtësia nuk funksionon dhe prandaj ndodhin ato ngjarje. Pra, shteti ka vetëm dëshirën dhe mundësinë për të gjetur justifikime, ndërkohë ndodhin ngjarje të tilla. Na ftuat për të vepruar? Ky është të vepruarit. Mbështete, imponoja sinjalin fort që ta zbatojë ligjin, dhe nëse ata e zbatojnë ligjin, nuk ndodhin ngjarje të tilla makabre, si ajo që ka ndodhur apo ato që mund të ndodhin në të ardhmen. Parësore nuk është funksionimi i shtetit, por është mbajtja nën tutelë politike e shtetit për interesa jo të qytetarëve, por për interesa personale. Ky buxhet dhe këto propozime për ndryshime përforcuan atë qëndrim që ne kemi mbajtur gjatë gjithë kohës. Këtë duhet t’ia themi publikut.

Sigurisht, ne jemi kundër

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Alibeaj!

Marrim edhe pyetjen e zonjës Dhurata dhe pastaj përgjigjuni ju.

Dhurata Çupi – Faleminderit, zonja kryetare!

Zoti Bllako, ne e dëgjuam këtu Autoritetin e Dosjeve dhe me sa unë kujtoj, pasi ishte akorduar nga ambasada suedeze fondi për godinën, që në vite ne ia premtanim në komision,

por nuk i jepej, ai kërkoi një fond për mobilimin e zyrave. U miratua kërkesa për mobilimin e zyrave apo jo? Ata nuk mund ta zhvillojnë aktivitetin nëse nuk kanë zyra. Ka që në vitin 2016 ky problem.

Kam edhe një pyetje tjetër. Nga perceptim, tani është kthyer në fakt që nga komisionet shkon tjetër relacion dhe në seancën parlamentare miratohet tjetër projektbuxhet. Kjo është e lidhur edhe me përgjegjësitë, sepse duke qenë organ kolegjal nuk ka përgjegjësi individuale, kurse ju e çoni në seancë plenare dhe e miratoni.

Për çfarë e bëj këtë hyrje? Keni deklaruar që fondi prej 900 milionë lekësh nuk do të jetë për Teatrin Kombëtar, por do të jetë për një teatër të Tiranës. A pranohet këtu që fondi nuk do të jetë për Teatrin Kombëtar, në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese?

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Zonja Çupi, këto pyetje ua keni bërë institucioneve të pavarura, ndaj nuk mund të diskutojë relatori për këto. Gjithsesi, nëse ka një përgjigje, mund t’jua japë.

Dhurata Çupi – Pretendimi është që ajo që miratohet në komision të mos ndryshohet në seancë plenare.

Klotilda Bushka – Ajo është tjetër gjë, por çështjen e zërave të veçantë ju e diskutuat në dëgjesa.

Zoti Xhafaj ka pyetje për relatorin.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Duke vlerësuar punën e bërë nga relatorët me shumë përgjegjësi dhe seriozitet për të ardhur deri këtu, unë kam një pyetje.

Ju prezantuat një listë kërkesash. Ndërkohë që ne flasim, kjo listë kërkesash a është negociuar me Komisionin e Ekonomisë dhe Ministrinë e Financave? Nëse nuk është negociuar dhe do të shkojë nga ky komision tani që flasim, ka një prioritarizim të tyre apo themi që kemi 100 kërkesa dhe me kaq e bëmë detyrën? Që ne të mos themi “ne e bëmë detyrën”, ndoshta duhen disa prioritete, të cilat e orientojnë komisionin tjetër, sepse është buxheti i shtetit dhe aq hapësirë ka, që të kuptojnë edhe kolegët tanë atje se çfarë është prioritet për ne dhe se çfarë duhet të kalojë. Këtë e kisha për pyetje informuese.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Po, zoti Alqi.

Alqi Billako – Faleminderit, zonja kryetare!

Për të bashkuar në sqarim komentim që bëri zoti Alibeaj, por edhe pyetjen e zotit Xhafaj, pasi lidhen me njëra-tjetrën, qëndrimi që unë mbajta si relator në propozimet që bëra (këtë mbase duhet ta kisha sqaruar në relatinim që bëra para pak minutave), jo domosdoshmërisht

është i rakorduar me Ministrinë e Financave. Pra, bazuar në propozimet që institucionet kanë bërë për nevojat që ata kanë për të përmbushur detyrat e tyre kushtetuese, kam dëgjuar kërkesat e tyre, kam marrë argumentet e tyre, kam bërë një diskutim me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe ka shumë raste, siç është edhe rasti i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ku propozimi im ka qenë për të mbështetur plotësisht kërkesat e këtij institucioni apo institucioneve të tjera të drejtësisë, pavarësisht mosdakordësisë së Ministrisë së Financave. Në fund është Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, i cili vendos për miratimin ose jo të këtyre shtesave buxhetore të kërkuara.

Propozimet e mia nuk janë të Ministrisë së Financave, por të relatorit, që i bëhen këtij komisioni për miratim dhe ka mjaft raste ku Ministria e Financave mund të mos jetë dakord në gjykimin tim për arsye jo objektive. Është tagër i këtij komisioni për t'i miratuar dhe për t'i përcjellë më pas për miratim në Komisionin përgjegjës të Ekonomisë dhe Financave.

Pa diskutim që ka një prioritarizim, që më së pari është logjik dhe pastaj në bazë projekti. Logjika të çon që nevojat për paga dhe sigurime shoqërore kanë prioritet absolut në përmbushje në mënyrë që institucioni të funksionojë. Më pas vijnë nevojat shtesë për shpenzime operative që lidhen me aktivitetin e përditshëm të këtyre institucioneve.

Prioriteti i tretë lidhet me investimet. Ne si komision gjatë seancave dëgjimore kemi listuar si prioritete sistemet digjitale të këtyre institucioneve, duke lënë në raste sporadike, siç ishte rasti i djegies së magazinës së Komisionit Qendror i Zgjedhjeve, që kishte nevojë për ndërhyrje imediate, fonde minimale për rikonstruksionin e këtyre ambienteve.

Propozimet e mia janë bërë pasi kam dëgjuar të dyja palët dhe janë arsyetim mbi nevojat objektive që kanë këto institucione dhe që jo domosdoshmërisht kanë miratimin e Ministrisë së Financave.

Klotilda Bushka – Zoti Sula, kishit ndonjë pyetje?

Dashnor Sula – Për sa i përket pushtetit vendor, duke pasur parasysh edhe kërkesat e dy shoqatave, ku problematikat që ato paraqitën ishin goxha të mëdha, dua të di nëse janë reflektuar, sepse ato ishin një mori kërkesash. Duke pasur parasysh çfarë problematike ka që të mos i hyjmë debatit, diskutimit, arsyeve pse, por nëse do të ishin reflektuar një pjesë e tyre do të ishte pozitive, nëse nuk janë reflektuar...

Klotilda Bushka – Zoti Bllako.

Alqi Bllako - Atëherë, kërkesat që shoqatat bënë ishin në parim dhe ne si komision çdo kërkesë të ardhur nga shoqata ia kemi paraqitur një për një, për shqyrtim dhe miratim komisionit përgjegjës, Komisionit të Ekonomisë, por nuk është tagri i këtij komisioni për të propozuar...

Dashnor Sula – Ky është mendimi juaj.

Alqi Billako - Patjetër, dhe do t'i propozohet në mbështetje komisionit përgjegjës.

Sa i përket Autoritetit të Dosjeve shtesa nuk lidhet vetëm me financimin e huaj në masën 67,2 milionë lekë dhe TVSH-në respektive, por është parashikuar edhe shtesa për zërin mallra shërbime, si dhe një shtesë tjetër në masën 10 milionë lekë, pra të gjitha kërkesat e tyre, janë pak a shumë të akomoduar.

Klotilda Bushka – Atëherë, kolegë, jemi dakord me sugjerimet e relatorit, që të vijojmë me miratimin nen për nen? Nenet janë shifra, ky ishte diskutimi në lidhje me projektligjin nen për nen. Besoj se jemi të gjithë jemi dakord ta hedhim në votim për procedurë. Kush është dakord? 13 vota pro. Kundër? 7 vota kundër.

Me 13 vota pro dhe 7 vota kundër, miratohen sugjerimet e relatorit të cilat do të shoqërojnë miratimin nen për nen dhe në tërësi që do t'i bëjmë tani projektligjit për buxhetin e vitit 2021.

Kush është dakord me nenin 1? Pro 13 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet neni 1.

Neni 2. Pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Neni 3. Pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Neni 4. Pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Neni 5. Pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Neni 6. Pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Neni 7. Pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Neni 8. Pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Neni 9. Pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Neni 10. Pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Neni 11. Pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Neni 12. Pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Neni 13. Pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Neni 14. Pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Neni 15. Pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Neni 16. Pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Neni 17. Pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Neni 18. Pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Neni 19. Pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Neni 20. Pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Neni 21. Pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Neni 22. Pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Votojmë në tërësi ligjin.

Fatmir Xhafaj - Para se ta votojmë në tërësi a mundem?

Po, patjetër.

Klotilda Bushka – Zoti Xhafaj.

Fatmir Xhafaj - Unë kam dy gjëra në relacion, zonja kryetare, për të dy relatorët.

Janë disa çështje që u thanë këtu dhe janë në rregull, edhe para disa kohësh edhe ne ramë dakord, prioritarizimi Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, Shkolla e Magjistraturës e të tjera, por kam dy gjëra për të cilat mendoj se duhet të jenë pjesë e relacioni.

E para, që është edhe më teknike, pavarësisht se s'bëhet fjalë për buxhet, janë disa gjëra që qeveria duhet t'i zgjidhë dhe ne duhet t'ia rekomandojmë asaj, siç është çështja e pagesave

te Prokuroria e Përgjithshme, e ekspertëve apo siç është çështja e godinës, në mos gaboj, e BKH-së, për të cilat ne duhet të bëjmë sugjerime. Vërtet nuk i zgjidh dot Kuvendi, por ia sugjeron, bën rekomandim. Ato që konsideroj më të rëndësishme bashkë me Komisionin e Ekonomisë, dhe që duhet të jetë në relacionin tonë, janë dy elemente që besoj se janë të rëndësishëm.

Së pari, duhet bërë një herë një analizë mbi nevojat e sistemit pas hartës së re gjyqësore. Pra, do të ketë një ndryshim dhe është nevoja të bëhet një analizë, mbas këtij ndryshimi çfarë do të ndodhë me gjykatat dhe me prokuroritë sigurisht për të kuptuar, kështu që duhet dhënë një rekomandim për ta bërë këtë analizë, nuk mund të thoni: “Jo, kur të vijë, që të ndryshohet buxheti”, se nuk ishte përgjigjja që do të duhet të dëgjonim në këtë mbledhje.

Tjetra, që është e rëndësishme, unë besoj se ka ardhur momenti dhe bie dakord me të gjithë ato zëra që thonë se duhet të ndryshojmë qasjen, metodologjinë e buxhetimit të institucioneve të pavarura dhe në mënyrë të veçantë të institucioneve kushtetuese dhe të drejtësisë. E thashë edhe në Kuvend në fjalën time dhe dëshiroj të përfaqësohet kjo gjë edhe nga pikëpamja formale në atë relacion, edhe si mendim i veçantë imi, por edhe si mendim që besoj se e ndajmë të gjithë, që duhet të ndryshojë metodologjia. Nuk mund të kemi të njëjtën qasje, sidomos mbas reformës në drejtësi, por edhe në princip, buxhetimin që bëjmë me institucionet e ekzekutivit duhet ta bëjmë edhe me institucionet e drejtësisë. Ndoshta është koha për të ndërtuar një tryezë në kohë, trepalëshe, sistem i drejtësisë – qeveri - Kuvend, në mënyrë që ta arrijmë këtë gjë në një mënyrë të re, në një metodologji që të jetë efiçente për t’u garantuar atyre jo vetëm pavarësinë substanciale, jo vetëm pavarësinë funksionale, strukturore, pro edhe pavarësinë financiare në kufijtë e ligjit që ka një buxheti i vendit.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Xhafaj!

Shumë e drejtë, në fakt në raportin e komisionit tonë çështje, të cilat nuk kanë lidhje me buxhetin, sepse nuk i përkasin në fakt zërave buxhetorë, por u përkasin zgjidhjeve konkrete, janë parashikuar dhe janë të shënuara sesi duhet të adresohen, pavarësisht faktit që nuk janë në buxhet, për ministrinë përkatëse, si dhe për qeverinë sa i takon godinave të institucioneve.

Ndërsa, çështjet e pagesave, të cilat janë ngritur në këtë komision gjatë dëgjesave, të cilat sipas relatorit janë vlerësuar si detyrime ligjore të paplotësuar, janë kërkuar si prioritete, nuk janë sugjerime. Çfarë është në ligj, është në ligj, ajo duhet të plotësohet. Ndërkohë, për çështjen e prioritarizimit të nevojave, mënyrën sesi do të realizohet buxhetimi i tyre nga komisioni përgjegjës, në fakt, ne do të mbarojmë këtë mbledhje këtu dhe do të kemi mbledhje me Komisionin e Ekonomisë edhe në nivel kryetarësh, por edhe me përfaqësues të qeverisë për

të diskutuar konkretisht mbi prioritarizimin e atyre që ne sugjerojmë si komision, sepse edhe ne do të donim t'i mbështesnim të gjitha, por siç e kemi thënë balancohen nevojat me mundësitë që ka buxheti. Prandaj flitet në bazë të parimit të prioritarizimit, por edhe qasja e mënyrës sesi buxhetohet.

Unë jam dakord me të gjithë kolegët që “po”, duhet parë në këndvështrim tjetër edhe konkretisht në këndvështrimin që çfarë është detyrim ligjor është e kotë të debatohet, çfarë janë mundësi të tjera për t'i përmirësuar çështjet, ne këtu jemi dhe e kemi mundësinë të luajmë një rol proaktiv në këtë përmirësim.

Besoj se me zotin Alqi dhe me zotin Klevis, i kemi diskutuar këto çështje dhe do të duhet të adresohen, sipas rekomandimeve edhe të zotit Xhafaj, edhe të kolegëve të tjerë.

Unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin!

Dua të hedh në votim në tërësi projektligjin për buxhetin e vitit 2022.

Kush është pro? 14 vota. Kundër? 7 vota.

Miratohet.

Me 14 vota pro dhe me 7 vota kundër, miratohet në tërësi projektbuxheti për vitin 2022.

Faleminderit, kolegë!

Për mbledhjen tjetër do të njoftoheni.

MBYLLET MBLEDHJA